



## Departamenti i Prokurimit

Prishtinë: datë, 23.09.2020

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Prishtinës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2) të Rregullave për Parashtrimin e Ankesave të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës 24.08.2020 të parashtruar nga **OE "Sallahu" Shpk**, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **"Ndërtimi i rrugëve në pjesët rurale me infrastrukture përcjellëse"**, me Nr. të Prok: **616-20-2390-5-1-1** dhe numër te brendshëm: **616 20 039 511** nxjerr:

### V E N D I M

1. **Aprovohet** kërkesa si pjeserishte e bazuar për ri-shqyrtim e **OE "Sallahu" Shpk** të dt. 21.09.2020 lidhur me aktivitetin e prokurimit **"Ndërtimi i rrugëve në pjesët rurale me infrastrukture përcjellëse"**, me Nr. të Prok: **616-20-2390-5-1-1** dhe numër te brendshëm **616 20 039 511** – për pjesën e I-re, ndërsa refuzohet kërkesa për rishqyrtim për pjesën e VII-te kundër *Njoftimit për tenderues te pasuksesshëm* te AK –së, të datës 15.09.2020.
2. Vërtetohet Njoftimi mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues për pjesën e VII-te, të publikuar me datë: 15/09/2020.

Autoriteti Kontraktues, vendos që ta kthej në rivlerësim aktivitetin e prokurimit për pjesën e I-re Ndërtimin e rrugës Stallove –Zllashë, dhe të vazhdoj me aktivitetin e prokurimit për pjesën e VII-te Ndërtimi i rrugës Dragovc - Gulmivade, me Nr. të Prok: **616-20-2390-5-1-1** dhe numër te brendshëm **616 20 039 511** – pjesa e VII-te, sipas Njoftimit mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues të datës: 15.09.2020.

3. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën : <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

### A r s y e t i m

**OE "Sallahu" Shpk** me datë 21.09.2020, ka parashtruar kërkesën për ri-shqyrtim, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **"Ndërtimi i rrugëve në pjesët rurale me infrastrukture përcjellëse"**, me Nr. të Prok: **616-20-2390-5-1-1** dhe numër te brendshëm **616 20 039 511**.

Autoriteti Kontraktues, me datë 23.09.2020, ka shqyrtuar kërkesën në fjalë si më poshtë:

- Lidhur me pretendimin I-re se OE i rekomanduar per kontrate per pjesen e I-re: Bujar Shabani – B.I, nuk ka plotesuar Aksin 5 te paramases te pershkrimi i çmimit – gjithsej 20 pozicione, **ky pretendim qendron** pasi OE i rekomanduar per kontrate per pjesen e I-re: Bujar Shabani – B.I, nuk ka plotesuar Aksin 5 te paramases per pjesen e I-re per: **Ndërtimin e rrugës Stallove - Zllashë.**

- Lidhur me pretendimin II-te se OE i rekomanduar per kontrate per pjesen e VII-te: “Kosova Asfalt” se edhe ky OE nuk ka plotesuar Aksin 5 te paramases te pershkrimi i çmimit – gjithsej 20 pozicione te pjeses se I-re dhe se edhe ky OE duhet te shpallet i papergjegjshem edhe per lotet tjera, **ky pretendim nuk qendron**, pasi qe OE i rekomanduar per kontrate “Kosova Asfalt” eshte i rekomanduar per pjesen e VII-te por jo per pjesen e I-re. OE i rekomanduar per pjesen e VII-te “Kosova Asfalt” eliminohet per pjesen e I-re por nuk mund te eliminohet per pjesen e VII-te pasi qe ky OE eshte i pergjegjshem per pjesen e VII-te dhe se tenderi ka qene i ndare ne pjese ku çdo lot paraqet tender dhe kontrate te veçante.

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar ne ato që u thane më lart ka vendosur si ne dispozitiv.

**Këshilla juridike:**

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së. **Ankesa prane OSHP-se duhet te dorezohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimit te ketij vendimi.**

  
Zyrtari përgjegjës i Prokurimit

